



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18416 Prot

Lezhë, më 23 / 10 / 2025

**PROJEKT-VENDIM**

**PËR  
EMËRTIMIN E RRUGËS ME NR. 57 03170051 ME EMRIN “GJERGJ KOVAÇI”  
NË FSHATIN TRESH, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN**

Mbështetur në ligjin 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; me kërkesë të komunitetit të zonës, përcjellë nga Njësia Administrative Zejmen, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Lezhë:

**Propozon:**

1. Emërtimin e rrugës me nr. 57 03170051 me emrin “Gjergj Kovaçi”, në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI  
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Protokolli  
Kartelë shoqëruese e praktikës

I. Dërgues

Njesia Admin. Zgjedhje

Nr. 414 Prot., Datë 15. 7 .2025

II. Marrësi : Bashkia Lezhë Nr. 12836 Prot., Datë 21. 7 .2025

Përmbajtja : Propozim për emërtim rruge

III. Për t/u trajtuar nga :

1. Keshilli i Bashkisë
2. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025

Shënim i Kryetarit \_\_\_\_\_

Afati kthimit të përgjigjes: ☐ 7 ditë ☐ 5 ditë ☐ 3 ditë ☒ 2 ditë ☐ Urgjent (brenda ditës)

Firmë \_\_\_\_\_

IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025

V. Për t/u trajtuar nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025

Shënim i Drejtorit të Drejtorisë: \_\_\_\_\_

Firmë \_\_\_\_\_

VI. Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025

VII. Për t/u trajtuar nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025

Shënim i Përgjegjësit të Sektorit: \_\_\_\_\_

Firmë \_\_\_\_\_

VIII. Marrë në dorëzim nga Specialisti i Sektorit përkatës \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025

Firmë \_\_\_\_\_

IX. Dorëzim i Eprorit porositisë, Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025

X. Shënim \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
NJESIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN

Nr. 414 Prot.

Zejmen, më 15.07.2025

**LËNDA:** Propozim për emërtim rruge.

**KESHILLIT BASHKIAK  
BASHKIA LEZHË**

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” kreu XI për “Drejtimin dhe funksionimin e strukturave administrative të Bashkisë” Neni 66 “Detyrat e Administratës së njësishë administrative” pika ë, si dhe bazuar në kërkesën e banorëve që frekuentojnë këtë rrugë dhe Kryesisë së fshatit Tresh, ju propozojmë që rruga me nr.57 03170051, ZK 3641 të emërtohet rruga “Gjergj Kovaçi” ndërsa rruga me nr. 46 03170051 ZK 3641 të emërtohet rruga “ Jak Kovaçi”.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë kërkesën e banorëve të fshatit Tresh hyrë në institucionin tonë me nr.prot 403 datë 11.07.2025 si dhe fragment harte nga Geoportali ASIG,segmentet rrugore me nr. 57 03170051 dhe 46 03170051.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

**ADMINISTRATORI  
Leonard PERJAKU**







Q Kërko

151 3641

REZULTATE

Parcelat Kadastrale

151

SIP\_R\_MDB 32900

SIP\_N 0

NR\_LNDERT 0.0

Inspirula

Numri / 151

pasurisë

Referenca

Kombetare

Kadastrale

E Vlefshme

Der

Pika

Reference

Vleresime

Saktësia e

Ilogarit

Zona 3641

Kadastrale

Filimi i Ciklit

Jetësor

Përfundimi i

ciklit jetësor

E Vlefshme

Nga

Burimi i të

dhënave

Sipërfaqja 17105.0

Gjeometrike

I AVANCUAR

SHTYPNI +

OPSIONE +

QËLLIMI +

## NDIHMË

Mjeti 'kërko' lejon përdoruesin të kërkojë objekte nga shtresat në bazën e të dhënave duke shtypur tekstin. Pas vendosjes së tekstit, rezultatet shfaqen nën 'Grupin e rezultateve'. Rezultatet janë grupuar sipas shtresave. Për të parë rezultatet brenda shtresës klikoni mbi shtresën dhe shfaqet lista e rezultateve. Klikoni në rezultatin e

KRGJSH

475048 721 4624374 593



Zolt Kovacs

REZULTAT  
Parapet: Krasni  
45-13-  
SIP P.M.B. 1200  
SIP N. 3  
NANDERT 800  
inspired  
Yumurt. 16/13  
patron  
Kadastre  
Evietski

Filmi T CİKİT  
Jetësor

Përfundimi i ciklit jetësor

E Vlefshme  
Nga

Burimi i të  
dhënave

Siperfaqja 733.0  
Gjeometrike

I AVANCUAR

*SHTYPNI* +

OPZIONE +

QËLLIMI +

## NDIHMĚ

Mjeti 'kërko' lejon përdoruesin të kërkojë objekte nga shtresat në bazën e të dhënave duke shtypur tekstin. Pas vendosjes së tekstit, rezultatet shfaqen nën 'Grupin e rezultateve'. Rezultatet janë grupuar sipas shtresave. Për të parë rezultatet brenda shtresës klikoni mbi shtresën dhe shfaqet lista e rezultateve. Klikoni në rezultatin e

© ASIG 0

KRGJSH

KĚRKO

KUSHTET E PËRDORIMIT



## KËRKESË ZYRTARE

Lënda: Kërkesë për emërtimin e dy segmenteve rrugore në fshatin Tresh me emrin e Gjergj Nikoll Kovaçit dhe Jak Kovaçit.

Drejtuar: Njesise administrative Zejmen.

Kërkues: Banorët e fshatit Tresh, Njësia Administrative Zejmen, Bashkia Lezhë.

Ne, banorët e fshatit Treshë, Njësia Administrative Zejmen, përmes kësaj kërkesë zyrtare, paraqesim propozimin tonë për emërtimin e dy segmenteve rrugore të fshatit me emrin e Gjergj Kovaçit dhe Jak Kovaçit, figura me kontribute të shquara ushtarake dhe atdhetare gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare. Gjergj Nikoll Kovaçi ka lindur në vitin 1903 në fshatin Treshë, në një familje me tradita të thella patriotike. Ai ka shërbyer si komandant i xhandarmërisë në Pukë dhe kryetar i Legalitetit në Lezhë, duke treguar përkushtim dhe integritet në mbrojtje të interesave kombëtare. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ai qëndroi përkrah forcave nacionaliste të Mirditës. Jak Kovaçi, djali i xhaxhait të tij, ndoqi të njëjtën rrugë patriotike dhe dha një kontribut të çmuar për çështjen kombëtare. Të dy u arrestuan më 21 mars 1953 dhe me vendimin nr. 117 të Gjykatës Ushtarake të Shkodrës, datë 24 korrik 1953, u dënuan “për bashkëpunim me diversantët”: Gjergj Kovaçi me 15 vjet burg dhe humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet, së bashku me Jak Kovaçin. Familjet e tyre vuajtën për një kohë të gjatë në kampet e internimit, duke dëshmuar sakrificën e tyre për idealet kombëtare. Ne vlerësojmë se figurat e tyre përfaqësojnë modele të ndritura të atdhetarit dhe ushtarakut të përkushtuar, duke mbartur vlera të larta njerëzore, profesionale dhe shoqërore, të cilat duhet të ruhen dhe të nderohen nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Emërtimi i dy segmenteve rrugore me emrat e tyre do të shërbente si një akt nderimi dhe kujtese për figurat e tyre dhe për të gjithë ata që kanë kontribuar në mbrojtjen e interesave kombëtare.

Bazuar në nenin 19 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kërkojmë që segmenti rrugor nga superstrada Lezhë – Shkodër deri te rruga e vjetër në aksin kryesor të fshatit Tresh me nr. pasurie 151 ZK3641, të emërtohet me emrin: “Rruga Gjergj Kovaçi” dhe rruga tjetër me nr. pasurie 46/13 të emërtohet me emrin: “Jak Kovaçi”.

Jemi të bindur se ky propozim do të marrë vëmendjen dhe miratimin e duhur nga ana juaj, si një akt i rëndësishëm për ruajtjen dhe promovimin e historisë lokale dhe vlerave kombëtare. Bashkëngjitur kësaj kërkesë, dorëzojmë edhe referencën historike dhe listën e banorëve nënshkrues që përkrahin këtë iniciativë.

Me respekt,

Banorët e fshatit Tresh







## Proces verbal

I mbajtur sot, në datën 13.10.2025, në  
shkatin "Tresh me pranimë" e kryetarit të  
këshillit z. Ndue Luli dhe këshilltarëve  
Alfonso Trastaj, Donike Ndoj, Rajmonde  
Prendaj si dhe kryetarit të Njësise  
Administrative z. Leonard Përgjaku, Sipas  
kërkesës së bashkëve për emërtimin e  
dy rrugëve me emrat "Gjergj Koveci" dhe  
"Jok Koveci".

Shprehin dakordimin:

- |                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| 1. Sokol Furukaj    | 12. ANTON KUVACI     |
| 2. NDUETOLI         | 13. Leonard Gjoka    |
| 3. Proys Masha      | 14. Markeliano Gjini |
| 4. Nohet Lok Mostur | 15. Anriello VOCI    |
| 5. Lendi NDUK Eper  | 16. RONALDO Gjini    |
| 6. NDUK CLESHI      | 17. Amarildo Huba    |
| 7. GJERGJ VOCI      | 18. Jeta Veseli      |
| 8. Kloudia Kadeli   | 19. RIGERSKJIN       |
| 9. Autoe beshi      | 20. Enver BOGRI      |
| 10. JUSTIN VOSHTI   |                      |
| 11. Gezim Preçi     |                      |



